



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR**

Data	
Nr. Prot	

**RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR**

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020, I
NDRYSHUAR, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR RREGULLAT E
RAPORTIMIT TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË CDO
INSTITUCIONI PUBLIK, E ME KAPITAL SHTETËROR, AGJENCIVE, ENTEVE
SHTETËRORE, KATEGORITË E VEPRIMTARIVE TË NDALUARA, SI DHE
MONITORIMIN E VEPRIMTARISË, SJELLJES DHE PËRDORIMIT TË
BURIMEVE NJERËZORE, FINANCIARE DHE LOGJISTIKE TË
ADMINISTRATËS SHTETËRORE PARA ZGJEDHJEVE**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË
FUQI**

Në mbështetje të nenit 12, pika 4, nenit 20, pika 1, shkronja “a”, nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e një anëtari të Komisionit Rregullator, Komisioni Rregullator vihet në lëvizje si organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij.

Neni 12, pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Neni 20, pika 1, shkronja “a” e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e projektaktit me karakter normativ, të përgatitur nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij.

Neni 91 “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore” (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020) është dispozita materiale e cila nevojitet të sistemohet dhe përshtatet në mënyrë më të qartë e sipas problematikave të referuara në raportet e OSBE/ODHIR.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Komisioni Rregullator në fillim të mandatit të tij në zbatim të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, me qëllim vendosjen e rregullave/normave për të patur një proces zgjedhor të pandikuar nga aktorë dhe faktorë të njëanshëm në administrim të institucioneve publike si: asetet publike, financat



publike, administrata publike dhe çdo instrument apo mekanizëm me impakt në prishjen e standartit të zgjedhjeve të lira e të ndershme, si dhe me synimin për të vendosur barazinë e “armëve” në një proces zgjedhor, që siç ka rezultuar deri tani është një synim “utopik” për vendin tonë, **miratoi vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.**

Vendimi nr. 9/2020, materializon parashikimet e neneve 91 “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore” dhe 92 “Veprimtaritë e institucioneve publike në fushatë” të Kodit Zgjedhor. Qëllimi i miratimit të këtij akti duhej të ishte rregullimi dhe disiplinimi i veprimtarisë së gjithë Institucioneve shtetërore në periudhën 4 muaj përpara e deri në ditën e zgjedhjeve.

Sa për kujtesën tuaj të nderuar kolegë, Vendimi nr.9/2020 është miratuar, së pari në një periudhë dinamike aktformuese dhe të vështirë në shumë drejtime, mbi të gjitha në drejtim të anës shëndetësore, për shkak të përhapjes së virusit Sars-Covid; e së dyti, është miratuar pas dekretit të Presidentit të Republikës i cili shpallte si datë për zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë, datën 25 Prill 2021.

Qëllimi i këtij akti ka qenë vendosja e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore e vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake.

Qartazi Kuvendi në miratimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, ka vendosur kufirin 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve duke u prirë nga parimet kushtetuese për të realizuar zgjedhje të lira e të pandikuara si dhe nën suazën e mbivalencës dhe avantazhit të pasjes pushtet dhe peshë nga ana e një force politike përpara datës së zgjedhjeve. Në këtë kontekst, do të ishte e nevojshme që partia e cila ka pushtetin të mos e shfrytëzonte as në “mala fede” këtë parashikim ligjor dhe as “majë më majë” dhe për hir të përkimit të pak ditëve më tepër mbi afatin 4 mujor të tregonte mungesë përgjegjshmërie duke miratuar konkretisht nisma dhe akte ligjore e nënligjore me qëllim ndikimin e drejtëpërdrejtë elektoral. Në fakt kështu ka ndodhur si përpara zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021 (kujtojmë këtu keqpërdorjen për efekt elektoral të ndarjes së banesave të reja për shkak të strehimit në to të banorëve të mebtur të pastrehë nga tërmeti i vitit 2019, kryesisht të zonës Durrës, Thumanë, Fushë Krujë, etj, premtimin për rritjen e pensioneve, shpërndarjen e parave për banesat e dëmtuara nga tërmeti në zonën e Durrësit, etj) ashtu edhe përpara zgjedhjeve të përgjithshme vendore të vitit 2023 (kujtojmë këtu premtimin e Kryeministrit Rama përpara zgjedhjeve mars 2023 për rritjen e pagave të Administratës), dhe fatkeqësisht e njëjta situatë e paligjshme po ndodh edhe përpara zgjedhjeve të datës 11 Maj 2025. Konkretisht më poshtë gjeni të renditura aktet konkrete:

- Të tilla si:
- a) Vendimi i ERE datë 08.1.2025 për “uljen e çmimit të energjisë”;
 - 2 b) Akti normativ i Qeverisë “Për Bonusin e Pranverës Për Pensionistët” i miratuar në Dhjetor

2024 por që efektin e jep në Prill 2025;

- c) Disbursimi i 501 milion USD nga buxheti i shtetit drejt Klientëve buxhetorë vetëm në 10 ditët e para të muajit Janar 2025;
- d) Vendimi nr. 21, datë 9 Janar 2025 (i cili ka hyrë në fuqi në datë 17 Janar 2025 FZ nr.10) i Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për 530 punonjës të Administratës Publike”
Etj etj.

Pavarësisht se nga pikëpamja formale procedurale aktet e miratuara nga Qeveria janë disa ditë tej afatit 4 mujor (*madje po të vlerësosh afatet e akteve në disa raste gjen që janë miratuar vetëm 24 apo 48 orë tej këtij afati*), të gjitha këto vendime të Qeverisë e japin efektin dhe pasojën brenda periudhës 4 – mujore, gjë që është e ndaluar nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe nga Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator duke përbërë qartazi avantazhe elektorale të padrejta apo keqpërdorime të burimeve shtetërore në favor të partisë në pushtet.

Në këtë kuadër, për vet ndikimin e padrejtë që japin këto urdhërime/vendime të Qeverisë e e në analizë dhe interpretim të dispozitat referuese mbi bazën e të cilave ngrihet përmbajtja e vendimit nr.9, datë 24.12.2020, nuk duhet kurrësesi që veprimtaritë publike vendimmarëse të kushtëzohen “prima facie” nga afati 4 mujor apo afati 1 mujor.

Sot, në vlerësimin dhe bindjen tonë rezulton se është tejet e nevojshme që **jo vetëm** normat e vendimit nr. 9/2020 duhet t’i nënshtrohen vetëm parimit kushtetues për të garantuar zgjedhje të lira e të pandikuara - *ndaj në këtë kuadër, të gjendur edhe para faktit të ekzistencës së një force politike e cila merr mbivalencë dhe avantazhe për hir të pasjes pushtet dhe forcë përpara ditës së zgjedhjeve*, **por** duhet të merret në konsideratë që ky **avantazh duhet të ngrijë që në momentin e shpalljes së dekretit të Presidentit të Republikës** për caktimin e datës së zgjedhjeve.

Pra, forca politike që drejton vendin duhet të jetë koshiente për supremacinë e saj në garë e në këto rrethana në një shtet demokratik duhej të mosndërmarrë akte e veprime që i japin privilegje kategorive të ndryshme të popullatës në fund të mandatit të saj qeverisë.

Në vlerësimin tonë, keqpërdorimi i burimeve shtetërore, së bashku me vjedhjen e votës janë “vrasësit” e zgjedhjeve të lira e të ndershme, dhe pa zgjedhje të lira e të ndershme nuk ka demokraci. Për fat të keq në të njëjtin konstatim të përbashkët me tonin “vrastar për demokracinë” kanë arritur edhe organizatat kombëtare e ndërkombëtare që operojnë në fushën e zgjedhjeve.

Siç jeni në dijeni, nga data e miratimit të këtij akti (vendimit nr.9, datë 24.12.2020) e deri më sot, në Shqipëri janë zhvilluar disa procese zgjedhore dhe konkretisht:

- a) Procesi zgjedhor për Kuvendin e Shqipërisë (25 Prill 2021);
- b) Procesi zgjedhor për zgjedhje të përgjithshme vendore (14 Maj 2023);
- c) Procesi zgjedhor për zgjedhje të pjesshme vendore (6 Mars 2022);
- d) Procesi zgjedhor për zgjedhjet e përsëritura për Kryetar Bashkie Rrogozhinë (23 Korrik 2023) ky është rasti tipik i keqpërdorimit kriminal të burimeve shtetërore për avantazhe të paligjshme elektorale;
- e) Procesi Zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar Bashkie Kukës (24 shtator 2023);
- f) Procesi Zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar Bashkie Himarë (4 Gusht 2024).

Referuar të gjithë raporteve të organizatave vendase e të huaja vëzhguese në proceset zgjedhore, veçanërisht referuar raporteve të Organizmit Ndërkombëtar më të Lartë e më të specializuar në zvëzhgimin e monitorimin e zgjedhjeve, Misionit të OSBE/ODHIR, ka rezultuar se:

Keqpërdorimi i Burimeve e Aseteve shtetërore është një nga elementët më thelbësorë në ndikimin e rezultatit zgjedhor.

Më konkretisht ju sjellim në vëmendjen se, në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODHIR për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin të vitit 2021, që në faqen e parë citohet:

“Partia qeverisëse përfitoi avantazhe të rëndësishme nga të qenit në pushtet, duke përfshirë edhe përmes kontrollit të administratave lokale dhe shpërdorimit të burimeve administrative. Kjo u amplifikua edhe nga mbulimi pozitiv i institucioneve shtetërore në media”.

Më tej akoma, në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODHIR për zgjedhjet e përgjithshme vendore të vitit 2023, po në faqen e parë citohet:

“Rastet e keqpërdorimit të burimeve shtetërore në nivel qendror dhe vendor, pretendimet për presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe zgjedhësit dhe pretendimet për blerje votash ishin shqetësuese”.

Po kështu edhe një sërë Organizatash kombëtare që operojnë në fushën e zgjedhjeve, veçanërisht organizata KRIIK ka denoncuar vazhdimisht keqpërdorimin e burimeve shtetërore duke marrë avantazhe të padrejta në procesin zgjedhor.

Të nderuar kolegë, vlen të theksojmë faktin se ndaj Vendimit nr. 9/2020 patën pritshmëri të gjithë aktorët e pavaruar e subjektet jo pushtetmbajtës, që ky akt të ishte një barrierë ligjore dhe referencë normuese për të gjitha insitucionet shtetërore e publike të të gjitha niveleve dhe kategorive, ndërkohë që u pa se ndodhi e kundërta, nga zbatimi në praktikë u konstatua gjerësisht, kombëtarisht e ndërkombëtarisht, përmes denoncimeve dhe raporteve publike të organizatave vendase e të huaja vëzhguese në këtë drejtim si OSBE/ODHIR, se jo vetëm ky akt u shkel dhe u neglizhua, por në shumë raste nuk është zbatuar fare.

Përpos sa mësipër, në kuadër të ndryshimeve të reja në Kodin Zgjedhor, ku për herë të parë në procesin zgjedhor përfshihen zgjedhësit nga jashtë, lind nevoja emergjente për shtesa e ndryshime në Vendimin nr.9/2020 në përshtatje me këto amendime të Kodit Zgjedhor.

Rrethanat dëshmojnë qartë se që nga data 11 Janar 2025, datë në të cilën sipas leximit që i bëjnë anëtarët e forcës politike në pushtet vendimit nr.9/20220 fillojnë efektet e zbatimit të vendimit për ndalimin e keqpërdorimit të burimeve shtetërore, dhe raportimin e veprimtarive me karakter publik, e deri më sot, rezulton se kemi **një sërë veprimtarish të ndaluara apo keqpërdorime të burimeve shtetërore të kryera edhe jashtë vendit** (këtu mund të përmendim rastin e Kreut të Bashkisë Fier me aktivitetin për emigrantën në Greqi, Ministrit Balla, Kreut të Grupit Parlamentar Peleshi për ngritjen e një zyre aplikimesh për regjistrim pranë Konsullatës Shqiptare në Selanik-Greqi, duke marrë tagrin e një KQZ paralele etj. etj).

Gjithashtu, një tjetër arsye shtesë për ndryshimin e vendimit nr. 9/2020 imponon dhe vendimmarrja e deritanishme e Organit tjetër Drejtues të KQZ siç është KAS, i cili në vendimarrjet e tij të herëpashershme ka hasur disa vështirësi dhe vakum ligjor lidhur me mospërcaktueshmërinë e unifikuar të afatit “mosushtrimor të veprimtarive publike me efekt elektoral apo publik” (4-mujor), në vendimin nr. 9, shih, neni 3 “Veprimtari të ndaluara”, pika 1.3, shkronja “c”. Ky fakt është evidentuar në të gjitha vendimarrjet e KAS, gjatë shqyrtimit të denoncimeve që kanë pasur të bëjnë me shkeljen e kësaj norme ligjore, si dhe në të gjitha analizat zgjedhore që KQZ ka zhvilluar.

Referuar gjithë sa sipër u relatua, rezulton e qartë se nevoja për ndryshime në aktin nr.9/2020 të Komisionit Rregullator është domosdoshmëri, në mënyrë që një proces zgjedhor të jetë i lirë, i barabartë dhe i drejtë dhe palët garuese të garojnë në mënyrë të ndershme e të barabartë. E nëse ndonjë prej palëve garuese (qartësisht pala e cila ka pushtetin vazhdues) nuk e koncepton dot “garimin në kushte të barabarta” atëhere duhet që ky “koncept i paligjshëm” të normohet e ti jepet fund me kuadër rregullator.

Në këto kushte, për hir të mundësisë incentivuese e nismëmarrëse që ligjvënësi na ka afruar në Kodin Zgjedhor, na lind përgjegjësia të marrim masat e nevojshme përmes mekanizmit të vënies në lëvizje të Komisionit Rregullatorit për të rregulluar/përshtatur normat në funksion të zgjedhjeve të lira e të pandikuara. Në këto pozita, Ne dy anëtarët e Komisionit Rregullator ndërmarrim nismën për propozimin e disa shtesave e ndryshimeve në Vendimin nr.9/2020, për të garantuar një proces zgjedhor të lirë, të ndershëm.

Në vazhden e kësaj iniciative na duhet të shënojmë edhe faktin se, në muajin Dhjetor me datë 21.12.2024 Vendimi nr.09. datë 24.12.2020 pësoi disa ndryshime e shtesa pjesore, të cilat preknin vetëm pjesën e rregullimit të veprimtarisë së raportimit nga ana e institucioneve shtetërore, publike të të gjitha niveleve e kategorive, ndërhyrje të cilat u propozuan nga ana e Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet me justifikimin e nevojës imediate për vënien në efencë të ndërfaqes raportues e cila kishte qenë në pamundësi funksionimi për të mundësuar raportimin në KQZ. Në diskutimet e këtij propozimi në seancë publike, dy anëtarët e Komisionit rregullator H.Vukaj dhe M.Çakaj kërkuan përpara miratimit të atyre ndryshimeve me atë rast, paraqitjen e propozimeve për shtesa e ndryshime në vendimin nr.9/2020 që kanë të bëjnë me veprimtaritë e ndaluara, brenda Dhjetorit 2024 dhe jo më larg se afati 10 Janar 2025. Në mbledhjen publike të datës 21 Dhjetor 2024 kemi marrë në mënyrë verbale deklarin nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (shprehur prej administratës që e përfaqëson) se ishte duke punuar për të bërë edhe ndryshime e shtesa në pjesën e Vendimit nr.9 për veprimtaritë e ndaluara.

Deri më sot, më datë 27 Janar 2025 (*rreth një muaj e gjysmë pas deklarimit të KSHZ*) rezulton të mos kemi asnjë propozim të ri në lidhje me premtimin e bërë për ndryshimin e pjesës së parë të vendimit nr.9/2020 për veprimtaritë e ndaluara. Në rrethanat kur s’kemi dijeni për asnjë projekt-akt apo propozim të KSHZ të njoftuar nga administrata apo vetë KSHZ për ndryshime/shtesa/përmirësime të domosdoshme të vendimit nr 9/2020, si dhe të gjendur para fakteve publike që dëshmojnë për shkeljen e vendimit nr.9/2020 kryesisht kronika televizive dhe denoncime publike, ku evidentohet se kanë filluar në mënyrë masive keqpërdorimet e burimeve shtetërore/publike brenda dhe jashtë vendit), rezulton se **ndërhyrja dhe marrja e masave për përshtatjen e përmbajtjes së vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 është tashmë e domosdoshme dhe e pashmangshme.**

Konkretisht ndryshimet dhe shtesat që vijnë përmes këtij projektvendimi janë të natyrës normative dhe kanë të bëjnë me:

Në nenin 1/1 “Parime të Përgjithshme” pikat 1, 2,3,4 dhe 5 riformulohen si më poshtë vijon:

1. **Parimi i ligjshmërisë:** Procesi i raportimit të të gjithë veprimtarive me karakter publik **brenda dhe jashtë vendit** nga Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve është detyrim ligjor. KQZ ka

5



përgjegjësinë dhe detyrimin ligjor t'i mbikqyrë, raportoje **dhe kur janë në kundërshtim me këtë Vendim t'i ndalojë ato.**

2. **Parimi i transparencës dhe informimit:** Të gjitha institucionet publike të çfarëdo niveli dhe çdo ent tjetër që kryen veprimtari publike **brenda dhe jashtë vendit** kanë përgjegjësinë e raportimit, me transparencë dhe objektivitet për të gjitha veprimtaritë me karakter publik, brenda afateve të ligjit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve zhvillon procesin e monitorimit dhe vlerësimit me transparencë dhe e bën atë publik.
3. **Parimi i drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit:** KQZ zhvillon procesin e vlerësimit të detyrimit për raportim të **veprimtarive publike brenda dhe jashtë vendit** dhe çdo denoncim të mbërritur në KQZ mbi bazën e parimit të drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit. Gjithashtu KQZ duhet t'i japë rëndësinë e duhur të gjithë informacioneve të ardhura në KQZ nga të tretë dhe subjektet politike.
4. **Parimi i sigurisë dhe përgjegjësisë për mos keqpërdorim të veprimtarive publike:** Të gjithë institucionet publike qendrore e vendore, që ushtrojnë veprimtari të karakterit publik **brenda dhe jashtë vendit**, si dhe KQZ e administrata e saj respektojnë të gjitha rregullat normuese që kanë të bëjnë me procesin e njoftimit të veprimtarive publike sipas afateve kohore të vendosura në Kodin Zgjedhor dhe kryejnë të gjitha procedurat që lidhen me këtë detyrim ligjor, me përgjegjësi e në përputhje me legjislacionin përkatës.
5. **Parimi i kontrollit:** Detyrimi për raportim në kohë i veprimtarive publike **të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit** dhe procesi respektiv, i nënshtrohen kontrollit administrativ, kontrollit gjyqësor dhe çdo kontrolli tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në nenin 2 “Përkufizime” shkronja “b” riformulohet si më poshtë:

“Veprimtari publike” janë të gjitha veprimtaritë me karakter publik e të përgjithshëm të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, të cilat duhet të ushtrohen pandikim, pa cënuar objektivin e përfitimit publik e pa qëllime të caktuara politike favorizuese. Veprimet publike janë të hapura për dëgjësë me publikun dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje, dhe për qëllime të këtij vendimi duhet të bëhen transparente sipas përcaktimit të agjendës së ushtrimit të tyre dhe të raportohen sipas përcaktimeve në këtë vendim.

Në nenin 3 “Veprimtari të Ndaluar”, në pikën 1.1 të shtohet titulli:

“Veprimtari të Ndaluar për tu Promovuar brenda dhe jashtë vendit”

Në nenin 3 “Veprimtari të Ndaluar”, pika 1.1 riformulohet si më poshtë:

“veprimtari të ndaluar për tu promovuar brenda dhe jashtë vendit” janë veprimtaritë publike të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit sipas përkufizimit të nenit 2 të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë”:

Në nenin 3 “Veprimtari të Ndaluar”, në pikën 1.3 të shtohet titulli:

“Veprimtari e ndaluar”.



Pika 1.3 të nisë me përkufizimin si vijon:

“... Veprimtari e ndaluar” konsiderohet çdo shprehje vullneti, çdo veprim apo çdo akt i nxjerrë nga Institucionet Shtetërore (ku përfshihen të gjitha Institucionet dhe zyrtarët e tyre siç përkufizohen në nenin 2 të këtij vendimi), që lejon përdorimin, vënien në dispozicion, si dhe krijon mundësi favorizuese në mbështetje të kandidatëve, partive politike, koalicioneve në zgjedhje, të çdo lloj burimi shtetëror që ata administrojnë.

Përdorimi, vënia në dispozicion, apo krijimi i mundësive favorizuese përfshin edhe shfrytëzimin e drejtpërdrejtë apo indirekt të aseteve, si dhe të çdo burimi financiar, njerëzor e publik nga administrata shtetërore për aktivitete zgjedhore, influencimin, mbështetjen për të siguruar akses, ndihmë në media dhe në platformat publike, në favor të një subjekti zgjedhor”.

Pas përkufizimit të mësipërm pika 1.3 fjalia e parë ekzistuese riformulohet si vijon:

“veprimtari të ndaluar” përfshijnë, por pa u kufizuar në:

Shkronja “c” e pikës 1.3 të nenit 3, të riformulohet si vijon:

c) vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve;

Në nenin 6 “Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit e administratës shtetërore” pika 5 të riformulohet si vijon”:

“gjatë pjesëmarrjes në veprimtari politike apo zgjedhore, nëpunësit civil i ndalohet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike dhe të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat. Gjithashtu i ndalohet të manifestojë me pankarta, parrulla apo çdo mjet tjetër të shkruar dhe të ekspozuar publikisht; i ndalohet të jetë protagonist në aktivitetet/veprimtaritë politike”.

Në nenin 6 “Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit e administratës shtetërore” pas pikës 7 shtohen pikat 8,9,10,11, me përmbajtje si vijon:

8. Punonjësit të Policisë së Shtetit i ndalohet:

- të jetë anëtar i një partie ose organizate politike;
- të mbështetë fushatën e një partie, organizate politike, të një anëtari partie politike apo të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë ose kontribuar fizikisht ose financiarisht.

9. Punonjësit të Gardës së Republikës i ndalohet:

- të sillet dhe të mbajë qëndrime që cenojnë natyrën e depolitizuar të Gardës;
- anëtarësimi e pjesëmarrja në veprimtari të partive a të shoqatave politike.

10. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i ndalohet:



- të manifestojë sjellje dhe të mbajë qëndrime, që cenojnë natyrën e depolitizuar të institucionit;
- anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e partive apo të shoqatave politike;
- të bëjë propagandë në favor ose kundër partive, shoqatave politike ose kundër kandidatëve në zgjedhje.

11. Ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura i ndalohet:

- të jetë anëtar i partive politike, i organizatave ose shoqatave me karakter politik;
- të marrë pjesë në veprimtaritë politike që organizohen prej tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ngarkohen Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim, për zbatimin e tij.

Sa më lart në këtë relacion, si anëtarë të Komisionit Rregullator, brenda kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, propozojmë për shqyrtim dhe miratim nga Komisioni Rregullator, projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, me titull **“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020, I NDRYSHUAR, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR RREGULLAT E RAPORTIMIT TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË CDO INSTITUCIONI PUBLIK, E ME KAPITAL SHTETËROR, AGJENCIVE, ENTEVE SHTETËRORE, KATEGORITË E VEPRIMTARIVE TË NDALUARA, SI DHE MONITORIMIN E VEPRIMTARISË, SJELLJES DHE PËRDORIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, FINANCIARE DHE LOGJISTIKE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE PARA ZGJEDHJEVE”**”.

ANËTARËT E KOMISIONIT RREGULLATOR

HELGA VUKAJ

MUHAREM ÇAKAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020, I
NDRYSHUAR, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR RREGULLAT E
RAPORTIMIT TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË CDO
INSTITUCIONI PUBLIK, E ME KAPITAL SHTETËROR, AGJENCIVE,
ENTEVE SHTETËRORE, KATEGORITË E VEPRIMTARIVE TË
NDALUARA, SI DHE MONITORIMIN E VEPRIMTARISË, SJELLJES DHE
PËRDORIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, FINANCIARE DHE
LOGJISTIKE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE PARA ZGJEDHJEVE”

Në mbështetje të nenit 12, pika 4, nenit 20, pika 1, shkronja “a”, neneve 91 e 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e një anëtari të Komisionit Rregullator,

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në nenin 1/1 “Parime të Përgjithshme” pikat 1, 2,3,4 dhe 5 riformulohen si më poshtë vijon:

1. **Parimi i ligjshmërisë:** Procesi i raportimit të të gjithë veprimtarive me karakter publik **brenda dhe jashtë vendit** nga Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve është detyrim ligjor. KQZ ka përgjegjësinë dhe detyrimin ligjor t’i mbikqyrë, raportojë **dhe kur janë në kundërshtim me këtë Vendim t’i ndalojë ato.**
2. **Parimi i transparencës dhe informimit:** Të gjitha institucionet publike të çfarëdo niveli dhe çdo ent tjetër që kryen veprimtari publike **brenda dhe jashtë vendit** kanë përgjegjësinë e raportimit, me transparencë dhe objektivitet për të gjitha veprimtaritë

me karakter publik, brenda afateve të ligjit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve zhvillon procesin e monitorimit dhe vlerësimit me transparencë dhe e bën atë publik.

3. **Parimi i drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit:** KQZ zhvillon procesin e vlerësimit të detyrimit për raportim **të veprimtarive publike brenda dhe jashtë vendit** dhe çdo denoncim të mbërritur në KQZ mbi bazën e parimit të drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit. Gjithashtu KQZ duhet t'i japë rëndësinë e duhur të gjithë informacioneve të ardhura në KQZ nga të tretë dhe subjektet politikë.
4. **Parimi i sigurisë dhe përgjegjësisë për mos keqpërdorim të veprimtarive publike:** Të gjithë institucionet publike qendrore e vendore, që ushtrojnë veprimtari të karakterit publik **brenda dhe jashtë vendit**, si dhe KQZ e administrata e saj respektojnë të gjitha rregullat normuese që kanë të bëjnë me procesin e njoftimit të veprimtarive publike sipas afateve kohore të vendosura në Kodin Zgjedhor dhe kryejnë të gjitha procedurat që lidhen me këtë detyrim ligjor, me përgjegjësi e në përputhje me legjislacionin përkatës.
5. **Parimi i kontrollit:** Detyrimi për raportim në kohë i veprimtarive publike **të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit** dhe procesi respektiv, i nënshtrohen kontrollit administrativ, kontrollit gjyqësor dhe çdo kontrolli tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Në nenin 2 “Përkufizime” shkronja “b” riformulohet si më poshtë:

“Veprimtari publike” janë të gjitha veprimtaritë me karakter publik e të përgjithshëm të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, të cilat duhet të ushtrohen pandikim, pa cënuar objektivin e përfitimit publik e pa qëllime të caktuara politike favorizuese. Veprimet publike janë të hapura për dëgjuesë me publikun dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje, dhe për qëllime të këtij vendimi duhet të bëhen transparente sipas përcaktimit të agjendës së ushtrimit të tyre dhe të raportohen sipas përcaktimeve në këtë vendim.

3. Në nenin 3 “Veprimtari të Ndaluar”, në pikën 1.1 të shtohet titulli:
“Veprimtari të Ndaluar për t’u promovuar brenda dhe jashtë vendit”
4. Në nenin 3 “Veprimtari të Ndaluar”, pika 1.1 riformulohet si më poshtë:
“Veprimtari të ndaluar për t’u promovuar brenda dhe jashtë vendit” janë veprimtaritë publike të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit sipas përkufizimit të nenit 2 të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë” por pa u kufizuar në: përdorimin e fondeve publike për mbështetje të subjekteve zgjedhore, vënien në dispozicion të burimeve shtetërore të natyrës materiale dhe njerëzore për qëllime elektorale.”
5. Në nenin 3 “Veprimtari të Ndaluar”, në pikën 1.3 të shtohet titulli:
“Veprimtari e ndaluar”.

6. Pika 1.3 të nisë me përkufizimin si vijon:
“... Veprimtari e ndaluar” konsiderohet çdo shprehje vullneti, çdo veprim apo çdo akt i nxjerrë nga Institucionet Shtetërore (ku përfshihen të gjitha Institucionet dhe zyrtarët e tyre siç përkufizohen në nenin 2 të këtij vendimi), që lejon përdorimin, vënien në dispozicion, si dhe krijon mundësi favorizuese në mbështetje të kandidatëve, partive politike, koalicioneve në zgjedhje, të çdo lloj burimi shtetëror që ata administrojnë.
Përdorimi, vënia në dispozicion, apo krijimi i mundësive favorizuese përfshin edhe shfrytëzimin e drejtpërdrejtë apo indirekt të aseteve, si dhe të çdo burimi financiar, njerëzor e publik nga administrata shtetërore për aktivitete zgjedhore, influencimin, mbështetjen për të siguruar akses, ndihmë në media dhe në platformat publike, në favor të një subjekti zgjedhor”.
7. Pas përkufizimit të mësipërm pika 1.3 fjalia e parë ekzistuese riformulohet si vijon:
“veprimtari të ndaluara” përfshijnë, por pa u kufizuar në:
8. Shkronja “c” e pikës 1.3 të nenit 3, të riformulohet si vijon:
...”c) vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësisive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve...”.
9. Në nenin 6 “Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit e administratës shtetërore” pika 5 të riformulohet si vijon:
“...gjatë pjesëmarrjes në veprimtari politike apo zgjedhore, nëpunësit civil i ndalohet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike dhe të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat. Gjithashtu i ndalohet të manifestojë me pankarta, parrulla apo çdo mjet tjetër të shkruar dhe të ekspozuar publikisht; i ndalohet të jetë protagonist në aktivitetet/veprimtaritë politike...”.
10. Në nenin 6 “Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit e administratës shtetërore” pas pikës 7 shtohen pikat 8,9,10,11, me përmbajtje si vijon:
“8. Punonjësit të Policisë së Shtetit i ndalohet:
- të jetë anëtar i një partie ose organizate politike;
- të mbështetë fushatën e një partie, organizate politike, të një anëtar i partie politike apo të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë ose

kontribuar fizikisht ose financiarisht.

9. Punonjësit të Gardës së Republikës i ndalohet:

- të sillet dhe të mbajë qëndrime që cenojnë natyrën e depolitizuar të Gardës;
- anëtarësimi e pjesëmarrja në veprimtari të partive a të shoqatave politike.

10. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i ndalohet:

- të manifestojë sjellje dhe të mbajë qëndrime, që cenojnë natyrën e depolitizuar të institucionit;
- anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e partive apo të shoqatave politike;
- të bëjë propagandë në favor ose kundër partive, shoqatave politike ose kundër kandidatëve në zgjedhje.

11. Ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura i ndalohet:

- të jetë anëtar i partive politike, i organizatave ose shoqatave me karakter politik;
- të marrë pjesë në veprimtaritë politike që organizohen prej tyre”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Ngarkohen Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim për zbatimin e tij
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar